



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 2645/16 prot.

Datë 07.01.2026

V E N D I M

Nr. 24/2026

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Anëtar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 07.01.2026, mori në shqyrtim çështjen me,

Objekt: Mbi zbatimin e vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr.1702/2025, datë 18.11.2025, për procedurën e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-50466-06-09-2025, me objekt “Uniforma” për nevojat e shoqërisë “Illyrian Guard” ShA” me fond limit 158,297,370.00 Lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 29-08-2025 nga autoriteti kontraktor, ILLYRIAN GUARD SH.A.

Ankimues: Operatori ekonomik “ARISA - KONFEKSION” SHPK me NIPT J61828068L dhe adresë Rruga 5 Maji, Nd. 82, Hyrja 7, Tiranë.

BOE “MALBERTEX shpk” me NIPT K71821009N dhe adresë Tirane Tirane Tirane, TIRANE, SIRI KODRA BLL.MAGAZINAVE, Tiranë & “UNIVERS PROMOTIONS shpk”.

Autoriteti Kontraktor: ILLYRIAN GUARD SH.A. me adresë Rruga Ibrahim Rugova, Tiranë 1016

Subjekt i interesuar: OE “Vojsava Zeneli” P.F., NUIS L12330004A, me adresë Bulevardi “Gjergj Fishta”, kulla nr. 2, kati i dytë, Tiranë.

Baza Ligjore: Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për

organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi dokumentacionin e çështjes dhe e diskutoi në tërësi,

Vëren:

I

Rrethanat e çështjes

I.1. Në datë 18.11.2025, Komisioni i Prokurimit Publik mori vendimin Nr.1702/2025, ku vendosi:

- 1. Të pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Arisa Konfeksion” SHPK në procedurën e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-50466-06-09-2025, me objekt “Uniforma” për nevojat e shoqërisë “Illyrian Guard” ShA me fond limit 158,297,370.00 Lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 29-08-2025 nga autoriteti kontraktor, ILLYRIAN GUARD SH.A.*
- 2. Të pranojë ankesën e paraqitur nga BOE ankimues “Univers Promotions” Shpk & “Malbertex” Shpk në procedurën e prokurimit objekt ankimi.*
- 3. Autoriteti kontraktor të rivlerësojë operatorin ekonomik “Arisa Konfeksion” SHPK, sipas konstatimeve në këtë vendim.*
- 4. Autoriteti kontraktor të rivlerësojë BOE ankimues “Univers Promotion” Shpk & “Malbertex” Shpk, sipas konstatimeve në këtë vendim.*
- 5. Autoriteti kontraktor brenda 5 ditëve të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.*
- 6. Ngarkohet zyra e financës që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Arisa Konfeksion” SHPK.*
- 7. Ngarkohet zyra e financës që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga BOE ankimues “Univers Promotions” Shpk & “Malbertex” Shpk.*
- 8. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.*
- 9. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.*

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

I.2. Me shkresën përcjellëse me nr. 187/113 prot., datë 31.12.2025, protokolluar me tonën me nr. 2645/13 prot., datë 05.01.2026, autortiteti kontraktor ILLYRIAN GUARD SH.A, ka dërguar me shërbim postar, informacion mbi zbatimin e vendimit të KPP-së Nr. 1702/2025, datë 18.11.2025.

-Kopje të Hetimit shterues mbi Korrespondencat me subjektet prodhuese;

-Procesverbal rivlerësimi i Komisionit të Vlerësimit të Ofertave me nr. 187/112 prot., datë 30.12.2025;

II

Komisioni i Prokurimit Publik

Pasi shqyrtoi dokumentacionin e mësipërm,

Arsyeton:

II.1. Me shkresën përcjellëse me nr. 187/113 prot., datë 31.12.2025, protokolluar me tonën me nr. 2645/13 prot., datë 05.01.2026, autortiteti kontraktor ILLYRIAN GUARD SH.A, ka dërguar me shërbim postar, informacion mbi zbatimin e vendimit të KPP-së Nr. 1702/2025, datë 18.11.2025. Bashkëlidhur është dërguara edhe:

-Kopje të Hetimit shterues mbi Korrespondencat me subjektet prodhuese;

-Procesverbal rivlerësimi i Komisionit të Vlerësimit të Ofertave me nr. 187/112 prot., datë 30.12.2025;

II.2. Nga verifikimi i raportit të auditit në sistemin e prokurimit elektronik si edhe informacioni i dërguar me shkresën përcjellëse me nr. 187/113 prot., datë 31.12.2025, protokolluar me tonën me nr. 2645/13 prot., datë 05.01.2026, nëpërmjet shërbimit postar, KPP konstaton se, autoriteti kontraktor ka kryer ri-vlerësimin e procedurës në sistemin e prokurimit elektronik në përputhje me vendimin e KPP-së Nr.1702/2025, datë 18.11.2025, duke kualifikuar operatorët ekonomikë BOE “MALBERTEX shpk” & “UNIVERS PROMOTIONS shpk” dhe operatorin ekonomik “ARISA - KONFEKSION” Shpk, ku këto veprime janë pasqyruar nga autoriteti kontraktor me informacionin e dërguar, duke bashkëlidhur edhe procesverbalit të rivlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave me nr. 187/112 prot., datë 30.12.2025.

Gjithashtu, pas rivlerësimit, autoriteti kontraktor ka cilësuar ofertën e BOE “MALBERTEX shpk” & “UNIVERS PROMOTIONS shpk” si ofertë anomalisht të ulët, për të cilën ka kërkuar sqarimet përkatëse në përputhje me parashikimet e ligjore, dhe në përfundim të analizës, për autoritetin kontraktor nuk është krijuar bindja se është e rregullt me të gjithë elementët e saj, dhe e ka skualifikuar këtë BOE, ku këto veprime janë pasqyruar nga autoriteti kontraktor me informacionin e dërguar si edhe në raportin e auditit të gjeneruar nga sistemi i prokurimit elektronik (SPE).

Për operatorin ekonomik “ARISA - KONFEKSION” Shpk, e cila u kualifikua sipas vendimit të KPP 1702 datë 18.11.2025, por pas verifikimeve të bëra nga autoriteti kontraktor mbi vërtetësinë e dokumentave që duhet të dorëzojë ky ofertues pranë kësaj të fundit, nuk është marrë asnjë përgjigje, dokumentuar kjo nga korrespondenca e dërguar si informacion pranë KPP-së dhe hetimi shterues, autoriteti kontraktor ka skualifikuar edhe ofertuesin “ARISA - KONFEKSION” Shpk, ku këto veprime janë pasqyruar nga autoriteti kontraktor me informacionin e dërguar si edhe në raportin e auditit të gjeneruar nga sistemi i prokurimit elektronik (SPE).

Përsa më sipër, mbështetur në nenet 30, 115 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimin e Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Nenin 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të lejojë autoritetin kontraktor për vijimin me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-50466-06-09-2025, me objekt “Uniforma” për nevojat e shoqërisë “Illyrian Guard” ShA” me fond limit 158,297,370.00 Lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 29-08-2025 nga autoriteti kontraktor, ILLYRIAN GUARD SH.A.
2. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Anila Malaj

Nënkryetar
Fiorent Zguro

